



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 25.02.2025

Nr: 194

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN**  
**NR. 44 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTIA**  
**DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** **Zj. Valbona Kola**  
Kryetar i Bashkisë Klos

**Zj. Hazbie Dedolli**  
Kryetar i Këshillit Bashkiak, Klos

**Z. Etmond Demiri**  
Sekretar i Këshillit Bashkiak, Klos

**OBJEKT:** Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht miratimi i akteve para fushatës zgjedhore të cilat synojnë dhënien e tokave në favor të subjekteve private, përdorimi i burimeve publike

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

**KONSTATOJ:**

Data: 25.02.2025

Nr: 194  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 44 ID datë 21.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partia Demokratike”

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 44 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Bashkia Klos në datën 28 Janar 2025 ka mbajtur mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, thirrur nga Kryetarja e Bashkisë zj. Valbona Kola, me rend dite ndër të tjera:*

- *Pika 7, e rendit të ditës “Shqyrtim dhe miratim projekt-vendim për ‘Për dhënie mendimi për fillim procedurash për dhënie në përdorim nga fondi pyjor i sipërfaqeve të kërkuara nga subjekte private “Green Energy Albania”;*
- *Pika ,8 e rendit të ditës ‘Shqyrtim dhe miratim projekt-vendim për ‘Për dhënie mendimi për fillim procedurash për heqje dhe dhënie në përdorim nga fondi pyjor i sipërfaqeve të kërkuara nga subjekte private “Dema Patin sh.p.k”;*
- *Pika 9, e rendit të ditës ‘Për dhënie mendimi për fillim procedurash për dhënie në përdorim nga fondi pyjor i sipërfaqeve të kërkuara nga subjekte private “Avni Allushi p.f”.*

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Zj. Valbona Kola, Kryetar i Bashkisë Klos;
- Zj. Hazbie Dedolli, Kryetar i Këshillit Bashkiak, Klos;
- Z. Etmond Demiri, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Klos.

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**